



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 557, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:41 dhe mbaroi në orën 13:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)
- 8. Marçela Shehu*** (anëtare)

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Illir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra dhe Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-NL)

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtim i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 557, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Çelet mbledhja plenare e datës 29 maj nga zonja Naureda Llagami.

Në rendin e ditës janë 4 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje.

Çështja e parë e rendit të ditës lidhet me projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr. 557, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit”. Projekt-akti ka ardhur në kuadër të akteve për zbatimin e hartës së re gjyqësore. Fjala i jepet relatores zonjës Shehu për të relatuar relacionin përkatës.

Zonja Shehu parashtron relacionin shpjegues që shoqëron projektvendimin si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efikasitetit, administrimit efektiv të gjykatave, dhe sigurimit të mirëfunksionimit të tyre në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, ka vijuar procesin për miratimin e rregullave më të detajuara për funksionimin e brendshëm të gjykatave të riorganizuara.

Në kuadër të këtij procesi, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90, shkronja “g” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 49 dhe 50 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ndër të tjera, ka miratuar dhe vendimin nr. 557 datë 29.12.2022 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisioneve të ristrukturimit”.

Ky akt përcakton rregulla të detajuara në lidhje me krijimin dhe funksionimin e Komisioneve të Ristrukturimit që ngrihen në kuadër të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave si dhe procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë gjyqësorë të konfirmuar në detyrë apo në periudhë prove, si dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë, që i nënshtrohen ristrukturimit për shkak riorganizimi, me qëllim transferimin e tyre të përhershëm, në kohën e duhur dhe me efektivitet, në strukturën e një gjykate tjetër.

Në këtë akt parashikohet se Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi kompetent ligjor, nxjerr aktin për krijimin e çdo komisioni Ristrukturimi, jo më vonë se dy ditë pas hyrjes në fuqi të aktit për miratimin e strukturës organizative, nga këshillat aktualë të Gjykatave pritëse.

Në kushtet kur tashmë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me miratimin e vendimit kuadër “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”, i referohet konceptit të gjykatës së riorganizuar, duke mos konsideruar njërin prej dy gjykatave si gjykatë pritëse, nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe

Buxhetit, është vlerësuar se ky vendim dikton nevojën e rishikimit dhe ndryshimit të vendimit nr. 557, datë 29.12.2022 të Këshillit “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisioneve të ristrukturimit”.

Sa më sipër propozohen disa ndryshime në vendimin nr. 557 datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këto ndryshime janë vënë në dispozicion anëtarëve.

Akti është hartuar në frymën tashmë të vendimit kuadër për fillimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime mbi sa u parashtrua, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit miratimi i projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatorja.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:41 dhe mbaroi në orën 13:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra dhe Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-NL)

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Mbledhja vijon me çështjen e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë me caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë. Edhe ky akt parashtrohet nga zonja Shehu.

Zonja Shehu parashtron relacionin shpjegues lidhur me projektvendimin “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë”, si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1, 147/a, pika 1, shkronja ‘ë’, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 84, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 14, 15 dhe 22 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

është organi përgjegjës për përcaktimin e kompetencave territoriale dhe të madhësisë së gjykatave.

Bazuar në dispozitën e mësipërme, pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.07.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimet:

Nr. 271, datë 25.05.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar”;

Vendimin nr. 272, datë 25.05.2023, “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë”

Këto vendime përcaktojnë parimet mbi të cilat do të bëhet riorganizimi i 6 gjykatave administrative të shkallës së parë dhe fillimin më dt. 01.07.2023 të funksionimit të 2 gjykatave administrative të shkallës së parë, me seli dhe kompetenca tokësore si më poshtë:

a) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me seli në qytetin e Tiranës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Elbasan, Lezhë dhe Korçë;

b) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, me seli në qytetin e Lushnjës dhe kompetencë tokësore, që përfshin rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Sarandë dhe Vlorë.

Në këto vendime, Këshilli ka parashikuar se numri i gjyqtarëve të Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnjë do të miratohet me akt të veçantë të tij.

Detyrimi i Këshillit për përcaktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë buron nga neni 22 i Ligjit 98/2016 i ndryshuar, “ Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon :

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mbikëqyr vazhdimisht ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave, duke u bazuar në të dhënat e mbledhura, me qëllim përmirësimin e efikasitetit të gjykatave ose zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor përgatit dhe publikon brenda muajit qershor të çdo viti raportin vjetor për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave për vitin kalendarik të mëparshëm, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e efikasitetit të gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës.

3. Të paktën çdo pesë vjet Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë dhe nëse është e nevojshme rishikon numrin e gjyqtarëve pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Gjykatës.

4. Procesi i përcaktimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë mbështetet në objektivat e parashikuar në nenin 14, të këtij ligji, me qëllim sigurimin e ngarkesës së ekuilibruar të punës së gjithë gjyqtarëve në Shqipëri. Procesi kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në analizën e raporteve vjetore dhe efikasitetit të masave të marra për zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportet vjetore, sipas pikës 2 të këtij neni.

Procesi i rivlerësimit të shpërndarjes së numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë (neni 22 i Ligjit 98/2016) është i ndryshëm nga ai i propozimit për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve (neni 21 i Ligjit 98/2016). Ky i fundit kërkon miratimin nga ana e Kuvendit bashkë me propozimin për buxhetin në sistemin gjyqësor. Ndërsa procesi i rishpërndarjes kërkon angazhimin e Këshillit për të rishikuar numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë, duke u bazuar tek totali i numrit të përcaktuar me Dekret të Presidentit (legjislativi në fuqi, neni 90 i Ligjit 98/2016)) aktualisht prej 408 gjyqtarësh.

I qartë për detyrimin ligjor si më sipër, Këshilli ka vlerësuar se rishikimi i numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, ishte proces që lidhej pazgjidhshmërisht me procesin e riorganizimit të kompetencave tokësore e rishikimit të madhësisë së gjykatave ndryshe të njohur si Harta e Re Gjyqësore (HRGJ), sepse të dy proceset kërkonin analizë disaveçare të ngarkesës së gjykatave, si dhe evidentimin e një normë mesatare ngarkese vjetore të çështjeve të reja për çdo gjyqtar të shkallës së parë të juridiksionit administrativ. Kjo e fundit u llogarit në kuadër të HRGJ, gjatë procesit të analizës së të dhënave statistikore për 5 vite (2016-2020).

Nga ana tjetër procesi i vlerësimit të numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, duhet të synojë realizimin në mënyrë të ekuilibruar të objektivave si : garantimin e aksesit në drejtësi, uljen e kostove me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike si dhe rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara, qëllime të përcaktuara në mënyrë taksative në nenin 14 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky proces duhet të mbajë gjithmonë në vëmendje parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 15 të ligjit të sipërcituar, si numrin minimal të gjyqtarëve për gjykatën e shkallës së parë (pika 3 e nenit), si dhe një numër mesatar të çështjeve në vit, jo më të vogël se mesatarja për gjyqtar e llogaritur me bazë vjetore, sipas analizës së bërë 3 vitet e fundit. Numri i gjyqtarëve lidhet pazgjidhshmërisht me krijimin e gjykatave të specializuara dhe rritjen e efikasitetit.

Në raportin e vlerësimit “Harta e Re Gjyqësore”, maj 2022, për gjykatat administrative të riorganizuara të shkallës së parë Tiranë dhe Lushnjë, analizohet se për të mbajtur ngarkesën mesatare por edhe për të maksimizuar efikasitetin në këto dy gjykata, numri total i pozicioneve duhet të ndryshojë në 42 gjyqtarë, sipas ndarjes 31 gjyqtarë për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe 11 gjyqtarë për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë. Mirëpo kjo analizë dikton rritjen e numrit të pozicioneve përtej numrit prej 36 gjyqtarësh të përcaktuar nga Dekreti i Presidentit. Për këtë arsye në korrik të vitit 2022, KLGJ kërkoi asistencën ndërkombëtare për të rishikuar shpërndarjen e ngarkesës për gjyqtarët e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, brenda numrit të miratuar prej 36 gjyqtarësh. Kjo analizë konkludoi se shpërndarja e burimeve duhet të jetë 27 gjyqtarë për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe 9 gjyqtarë për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

Në pamundësi për të ndryshuar numrin total të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor, proces i cili tejkalon analizën e vlerësimit të bërë në kuadër të HRGJ, sepse përfshin edhe vlerësimin për Gjykatën e Lartë e Gjykatën Administrative të Apelit, Këshilli tashmë e ka një raport vlerësues të ngarkesës mbi të cilin mund të gjykojë për ndryshimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë.

Duke mbajtur parasysh parimet e lartpërmendura, është konkluduar se për të ruajtur mesataren kombëtare të ngarkesës me çështje gjykatat administrative të shkallës

së parë duhet të kenë këtë numër gjyqtarësh: Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 27 (njëzet e shtatë) gjyqtarë. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, 9 (nëntë) gjyqtarë.

Ky numër është i barabartë me numrin e pozicioneve të gjyqtarëve të shkallës së parë të juridiksionit administrativ të alokuar aktualisht në sistemin gjyqësor, pra 36 gjyqtarë.

Më poshtë është evidentuar numri i pozicioneve aktuale në gjykatat administrative të shkallës së parë ku në total janë 36 gjyqtarë.

Pas një analize të kombinuar të të gjithë indikatorëve, faktorëve dhe objektivave të parashikuar nga neni 14 i Ligjit Nr. 98/2016 i ndryshuar, konkludohet se përcaktimi i numrit të gjyqtarëve sipas projekt-aktit të KLGJ-së, është aktualisht mekanizmi kryesor i ekuilibrit të ngarkesës së gjykatës dhe vetë gjyqtarëve, duke siguruar një rishpërndarje të drejtë të ngarkesës së gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë.

Mesatarja në rang kombëtar (e ponderuar) e ngarkesës së punës rezultoi 378 çështje për gjyqtar në gjykatat administrative të shkallës së parë, përgjatë periudhës 2018-2020.

Për të përcaktuar ngarkesën e punës treguesit janë vlerësuar duke kërkuar vendosjen e një ekuilibri midis shpërndarjes së ngarkesës së punës, shpërndarjes së gjyqtarëve ndërmjet gjykatave, si dhe numrit minimal të gjyqtarëve në çdo gjykatë.

Ngarkesa e gjykatës është përcaktuar jo vetëm nga numri total i çështjeve të reja, por edhe nga lloji i këtyre çështjeve, pra nëse çështjet e ndërlikuara dhe ato që marrin kohë përbëjnë përqindjen më të vogël apo atë më të madhe të çështjeve të një gjykate.

Më poshtë janë edhe vlerësimet në lidhje me ngarkesën.

Bazuar sa më sipër Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë” me këtë përmbajtje:

Numri i gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë është si më poshtë: 1. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 27 (njëzet e shtatë) gjyqtarë. 2. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, 9 (nëntë) gjyqtarë.

Parashikohet gjithashtu që ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime mbi sa u parashtrua, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit miratimi i projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Këshilli vendosi:

Numri i gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë është si më poshtë:

1. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 27 (njëzet e shtatë) gjyqtarë.

2. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, 9 (nëntë) gjyqtarë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:41 dhe mbaroi në orën 13:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Ilir Rusi*.

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra dhe Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-NL)

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Mbledhja vijon me çështjen e tretë të rendit të ditës që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, për kandidatin z. {...}. Fjala i jepet relatorit të çështjes z. Alban Toro.

Zoti Toro parashtron shkurtimisht relacionin shpjegues lidhur me projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, për kandidatin z. {...}”, si më poshtë:

Në kuadër të përpjekjeve që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë për plotësimin e vendeve vakante, me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, Këshilli ka hapur procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ku një nga kandidatët që ka kandiduar për këtë pozicion ka qenë edhe zoti {...}, gjyqtar i Gjykatës administrative të Shkallës së Parë Korçë, për të cilin nga ana e Këshillit, në kuadër të procedurës së verifikimit dhe të përzgjedhjes, janë ndërmarrë disa vendimmarrje.

Kështu me vendimin nr. 334, datë 28.07.2021 Këshilli ka vendosur:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Për kandidatin z. {...}, i cili ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 187, datë 28.05.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, procedura e verifikimit të kriterëve të kandidimit që ka përfunduar për këtë kandidat, është e vlefshme edhe për kandidimin e tij për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me vendimin nr. nr.356, datë 09.09.2021, ka vendosur: 1.Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë me vendimin nr. 393, datë 22.09.2021, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke caktuar edhe relatorin.

Me vendimin nr. 231, datë 11.05.2023 Këshilli ka vendosur:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1) Znj. {...}

2) Z. {...}.

Në pritje të miratimit apo ankimit të kësaj renditjeje nga ana e relatorit u disponua kërkesa e z. {...} i cili në datën 18.05.2023, protokolluar në Këshill me aktin 2930, ka parashtruar se tërhiqej nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021 të KLGJ-së për arsye se do të kandidonte për pozicionet e lira të cilat priten të shpallen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Natyrisht vullneti i gjyqtarit është i rëndësishëm pasi është përfshirë edhe në aktet rregullative të Këshillit, parashikuar nga pika 7, Seksioni B, kreu VI i vendimit të Këshillit nr. ..., dhe në respekt të këtij urdhërimi nga ana e relatorit është përgatitur projekt-akti përkatës, në dispozitivin e të cilit sugjerohet të miratohet:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime mbi sa u parashtrua, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit miratimi i projekt-aktit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...} , për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:41 dhe mbaroi në orën 13:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra dhe Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala dhe Olta Lolo, Eksperte (EWMI-NL)**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Mbledhja vijon me çështjen e fundit të rendit të ditës që ka të bëjë me ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}. Fjala i jepet relatorit të çështjes z. Alban Toro.

Zoti Toro parashtron shkurtimisht relacionin shpjegues lidhur me projektvendimin “Për ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}”, si më poshtë:

Më herët nga ana e Këshillit, me vendimin nr.231, datë 11.05.2023, është vendosur:

“1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me

Vendimin nr. 290, datë 06.07..2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Znj. {...}, 2) {...}.

Të dy magjistratëve i është dërguar ky vendim pasi ata gëzonin të drejtën e ankimit ndaj tij dhe kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike në datën 11.05.2023, protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., konfirmoi marrjen e njoftimit për vendimin si më lart të Këshillit. Po ashtu, kjo kandidate, në rrugë elektronike, i bëri të ditur Këshillit të Lartë Gjyqësor se nuk ka ankim ndaj vendimit. Ndërkohë që Kandidati z. {...}, në vijim të procedurës së renditjes dhe në pritje të afateve të ankimit sipas pikës 3 të vendimit të renditjes nr.231 datë 11.05.2023, me shkresën e datës 18.05.2023 protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., ka parashtruar se tërhiqej nga kandidimi për pozicionin e lirë, i shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për arsye se do të kandidonte në pozicionet e tjera të cilat priten të shpallen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në zbatim në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.75, datë 23.05.2019, pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, me vendimin e sotëm, vendosi:

“1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...} , për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.”

Në këto kushte kandidatja ka mbetur e vetme dhe për pasojë nga ana e relatorit është përgatitur projektvendimi, në dispozitivin e të cilit sugjerohet të miratohet:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 12.06.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lidhur me efektet juridike të vendimit sqarohet se për përcaktimin e tyre është mbajtur në konsideratë konfliktet gjyqësore të cilat kandidatja ka aktualisht në gjykim, duke iu lënë kohë për të mundësuar përfundimin e vendimeve, pasi një pjesë e mirë e tyre ishin në bisedime përfundimtare. Prandaj është përzgjedhur kjo datë për t'i dhënë kohë të mjaftueshme për të mbyllur ato praktika gjyqësore të cilat janë pothuaj në stadin e fundit të pritjes së një vendimi gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime mbi sa u parashtrua, ndaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit miratimi i projekt-aktit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. {...}.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 12.06.2023.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor